

Barometri i Reformave Evropiane

Janar 2024



Titulli i publikimit:

Barometri i Reformave Evropiane – janar 2024

Publikuar nga:

Grupi për Studime Politike dhe Juridike (GLPS)
Instituti i Kosovës për Politikën Evropiane (EPIK)

Dizajni grafik:

2vo

Prishtinë, janar 2024

Ky raport është hartuar me mbështetjen e Ambasadës së Holandës në Kosovë. Përmbajtja e tij është përgjegjësia e vetme e Grupit për Studime Politike dhe Juridike dhe Institutit të Kosovës për Politikën Evropiane dhe në asnjë formë nuk pasqyron pikëpamjet e Ambasadës së Holandës në Kosovë.



Group for Legal
and Political
Studies

epik.

NL Netherlands

Barometri i Reformave Evropiane

Përmbajtja

Hyrja	4
Metodologjia	4
Përmbledhja ekzekutive	7
Rangimi Evropian	9
Ministria e Ekonomisë (ME)	10
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)	14
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)	22
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)	28
Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)	32
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT)	40
Ministria e Drejtësisë (MD)	49
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)	52
Ministria për Kthim dhe Komunitete (MKK)	60
Ministria e Shëndetësisë (MSH)	63
Zyra e Kryeministrit (ZKM)	67
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS)	71
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)	74

Hyrja

Është kënaqësia jonë e veçantë që të prezantojmë edicionin e parë të Barometrit të Reformave Evropiane. Në vitin 2023 Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe Instituti i Kosovës për Politikën Evropiane (EPIK), me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë, kanë bashkuar forcat për të dizajnuar një instrument të ri për vlerësimin sistematik dhe gjithëpërfshirës të performansës së Qeverisë së Kosovës në zbatimin e reformave Evropiane.

Barometri i Reformave Evropiane ka tre qëllime parësore: (1) të avancoj diskursin publik mbi zbatimin e reformave evropiane duke komunikuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme reformat respektive; (2) të rris transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve duke ofruar vlerësim strikt, por fer, të performansës së ministrive të linjës; dhe (3) të mbështes ministrinë në dizajnimin sa më efektiv të reformave evropiane duke ofruar analizë objektive dhe empirike mbi kornizën planifikuese të qeverisë në fushën e integritit evropian.

Për të arritur këtë ne është dashur të dizajnojmë një metodologji unike e cila synon të bëjë një vlerësim holistik të kornizës planifikuese të qeverisë në fushën e integritit evropian duke marr për bazë dy dokumente kryesore planifikuese të ekzekutivit në fushën e integritit Evropian: Planin Kombëtar për Integrim Evropian dhe Agjendën Evropiane të Reformave. Periudha e vlerësimit të këtij barometri është janar – dhjetor 2023.

Në fund dëshirojmë të falënderohemi të gjitha ministrive të linjës për bashkëpunimin dhe transparencën gjatë përgatitjes së barometrit, dhe natyrisht Ambasadën e Mbretërisë së Holandës pa mbështetjen e së cilës e gjithë kjo nuk do të ishte e mundur.

Metodologjia

Barometri i Reformave Evropiane është zhvilluar mbi një metodologji unike e cila është dizajnuar për të siguruar një vlerësim gjithëpërfshirës të cilësisë së kornizës planifikuese të Qeverisë në fushën e integritit evropian.

Vlerësimi tradicional i performansës së qeverisë bazohet ekskluzivisht në një kriter vlerësues: shkalla e zbatueshmërisë së kornizës planifikuese. Sidoqoftë, ne kemi konsideruar se një vlerësim i tillë nuk do të ishte i mjaftueshëm dhe i drejtë; dhe si i tillë do të na ofronte një pikturë të shtrembëruar të performansës së ministrive në procesin integruar. Rrjedhimisht metodologjia e barometrit bazohet në katër kritere të vlerësimit të cilat ofrojnë një vlerësim më holistik dhe më të drejtë:

1. Kriteri i parë i kompleksitetit bënë vlerësimin e vështirësisë së masave të Qeverisë. Pra, jo të gjitha masat e planifikuara nga ana e ministrive të linjës kanë peshën dhe vështirësinë e barabartë. Disa

masa janë shumë më të vështira për tu zbatuar se disa të tjera. Përgatitja e një strategjie dhe organizimi i një trajnimi nuk është e njëjta gjë. Rrjedhimisht, qëllimi i këtij kriteri është që të sigurojë se vlerësimi përfundimtar i performansës së ministrive në zbatimin e reformave evropiane merr parasysh kompleksitetin e masave për të cilat ministrinë janë zotuar, duke shpërblyer kështu ato ministrinë të cilat kanë bërë një planifikim më serioz dhe më të avancuar të reformave evropiane. Ky kriter bart 25% të pikëve totale të vlerësimit.

2. Kriteri i dytë bënë vlerësimin e saktësisë së kornizës planifikuese të Qeverisë në procesin integruar. Pra është e rëndësishme që masat të cilat qeveria ka paraparë në kuadër të kornizës së saj planifikuese të janë në harmoni me obligimet të cilat qeveria ka marr në kuadër të procesit integruar. Thënë ndryshe qëllimi i këtij kriteri është që të sigurojë se Qeveria është duke bërë gjërat e duhura në procesin integruar, duke shpërblyer kështu ato ministrinë të cilat kanë siguruar një përputhshmëri më të madhe në mes obligimeve në procesin integruar dhe kornizës planifikuese të ministrisë. Ky kriter bart 35% të pikëve totale të vlerësimit.
3. Kriteri i tretë është kriter klasik i cili thjesht bënë vlerësimin e zbatueshmërisë së kornizës planifikuese nga ana e ministrive, duke shpërblyer kështu ministrinë me shkallën më të lartë të zbatimit të masave në kuadër të procesit integruar. Ky kriter bart 30% të pikëve totale të vlerësimit.
4. Kriteri i katërt është vlerësim i një faktori të jashtëm për performancën e çdo ministrie e ai është vlerësimi i Komisionit Evropian në kuadër të raportit të BE-së. Raporti i BE-së ofron një vlerësim të kuantifikueshëm të performansës vjetore të Kosovës në kuadër të kapitujve të ndryshëm të BE-së. Në masë të madhe këto kapituj përputhen me mandatet dhe fushë përgjegjësitë e ministrive të linjës. Rrjedhimisht qëllimi i këtij kriteri është që të shpërblejë me pikë shtesë ato ministrinë të cilat Komisioni Evropian ka vlerësuar se kanë bërë progres vjetor më të madh se vitin paraprak. Ky kriter bart 10% të pikëve totale të vlerësimit.

Mbledhja totale e pikëve të fituara në kuadër këtyre katër kriterëve ofron rezultatin përfundimtar të performansës së ministrisë në kuadër të zbatimit të reformave evropiane. Çdo ministri eventualisht fiton një numër të pikëve në shkallën nga 0 deri 100, sipas gradimit të më poshtëm:

- 0-25 pikë** performansë e dobët;
- 26-50 pikë** performansë e kufizuar;
- 51-75 pikë** performansë e mirë;
- 76-100 pikë** performansë shumë e mirë.

Duhet nënvizuar se unikaliteti i barometrit qëndron në faktin se është dashur të dizajnohet një metodologji e veçantë e cila me një anë do të jetë mjaft teknike për të analizuar kornizën komplekse dhe voluminoze të planifikimit të qeverisë në fushën e integritimit evropian, por në anën tjetër do të jetë mjaft e thjeshtë dhe e qartë për të kuptuar jo vetëm nga ana e ministrive të linjës, por edhe nga ana e publikut të gjerë. Kjo është edhe arsyeja përse produkti final i barometrit përbëhet nga tre nivele të informatave për tre audiencat e ndryshme.

Niveli i parë dhe më voluminozi është ai i vlerësimit teknik të ministrive ne formatin Excel. Ky nivel i barometrit është i menduar për diskutime teknike në nivel të ekspertëve. Ai po ashtu shërben si bazë e të dhënave teknike për ndërtimin e niveleve të tjera të barometrit.

Niveli i dytë i barometrit është ai në formatin Word i cili prezanton të dhënat teknike të Excelit në një format më të kuptueshëm dhe të lexueshëm për audiencën e cila nuk përcjell procesin integruar në baza ditore. Ky nivel i barometrit është i menduar për nivelin e vendimmarrëseve institucional, ambasadat e huaja, OJQ-të dhe mediat.

Niveli i tretë i barometrit është ai i platformës online i cili në mënyrë vizuale dhe interaktive prezanton gjeturat më të rëndësishme lidhur me performansen e ministrive në procesin integruar. Ky nivel i barometrit është i menduar për audiencën e gjerë me ç'rast çdo kush me një klikim mund të kuptojë përgjegjësitë dhe performansen e ministrive në kuadër të reformave evropiane.

Në fund është e dobishme të sqarojmë edhe çfarë barometri nuk është. Barometri nuk është vlerësues i punës së të gjitha institucioneve të Kosovës në fushën e integritetit Evropian. Rrjedhimisht institucione të rëndësishme sikur Kuvendi, prokuroria, gjyqësori dhe institucione të tjera të pavarura nuk janë pjesë e këtij vlerësimi. Arsyeja mbrapa këtij vendimi është teknike dhe financiare. Pra teknike pasi që duke pas parasysh që barometri është një instrument krejtësisht i ri kemi dashur të testojmë suksesin e tij brenda një grupi institucionesh të cilat kanë një koherencë dhe uniformitet funksionimi. Kjo do të na ofronte një mjedis të kontrollueshëm dhe të krahasueshëm të barometrit. Po ashtu, vendimi ynë është udhëhequr edhe nga fakti që ekzekutivi bart përgjegjësinë krahasimisht më të madhe brenda procesit integruar. Po ashtu, vendimi për të filluar barometrën vetëm me ekzekutivin ishte edhe i natyrës financiare pasi që zgjerimi në më shumë institucione do të ndikonte në vëllimin financiar të projektit i cili momentalisht kishte kufizime e veta objektive. Barometri po ashtu nuk është vlerësues i performancës së përgjithshme të ministrive. Nuk duhet konfuzuar vlerësimin dhe rangimin e ministrave brenda këtij barometri me performancën e përgjithshme të ministrave. Ministrat udhëheqin ministritë me fushë përgjegjësitë jashtëzakonisht të gjëra të cilat tejkalojnë obligimet e tyre në procesin integruar. Rrjedhimisht, është e domosdoshme të nënvizohet se rangimi i ministrave në kuadër të barometrit ka të bëjë ekskluzivisht me performancën e dikastereve që ata udhëheqin brenda fushës së integritetit evropian.

Përmbledhja ekzekutive

Përpara së të bëjmë prezantimin e përmbledhur të Barometrit të Reformave Evropiane është e dobishme të vendosim rezultatet e barometrit në sfondin e zhvillimeve politike të cilat kanë karakterizuar agjendën evropiane të vitit 2023, pasi që këto zhvillime kanë ndikuar drejtpërdrejt në vullnetin dhe kapacitetin e institucioneve të Kosovës për të avancuar agjendën evropiane.

Procesi integrues i Kosovës ka pasur zhvillime pozitive dhe negative në vitin që lamë pas. Nga këndi pozitiv kemi pasur tre dinamika inkurajuese. E para, gjatë këtij viti Bashkimi Evropian më në fund liberalizoj vizat për qytetarët e Republikës së Kosovës. Ky akt rikthej besimin e qytetarëve të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe ofroj incentivë të rëndësishme për institucionet e Kosovës për të vazhduar me reformat evropiane. E dyta, BE-ja propozoj Planin e ri të Rritjes Ekonomike për Ballkanin Perendimor duke vënë në dispozicion 6 miliardë euro me qëllim të rritjes së konkurrueshmerisë së vendeve të rajonit dhe përafrimit të tyre me tregun e vetëm evropian. Dhe e treta, dialogu me Serbinë njohu progres me arritjen e "Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", të dakorduar në Bruksel me 27 shkurt 2023, si dhe shtojcës respektive të dakorduar në Ohër me 18 mars 2023.

Sidoqoftë, nga këndi negativ kemi pasur tre dinamika të cilat kanë qenë arsye për brengosje. E para, përkundër arritjes së marrëveshjeve politike, Kosova dhe Serbia nuk treguan vullnet politik për normalizimin e marrëdhënieve. Kjo rezultojë në degradimin serioz të situatës sigurisë në Kosovës me ç'rast: (1) Serbia kidnapoj tre zyrtarët policor të Kosovës, (2) protestuesit e dhunshëm serb lënduan pjesëtarët e KFOR-it dhe gazetarët, dhe (3) u organizua sulm paraushtarak mbi policinë e Kosovës në Banjska me ç'rast humbi jetën një zyrtar policor i Kosovës. Një mjedis i tillë sfidues i sigurisë ka lënë shumë pak hapësirë për diskutimin e reformave strukturore evropiane. E dyta, gjatë periudhës raportuese Kosova ka qenë nën masat e BE-së të cilat kanë shkaktuar Kosovës kosto politike, teknike dhe financiare. Në kuptimin politik, vendosja e Kosovës nën masat e BE-së ka dërguar mesazh jo të mirë për Kosovën në skenën ndërkombëtare. Në kuptimin teknik, institucionet e Kosovës janë privuar nga dialogu i rregullt në kuadër të strukturave të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimi dhe ekspertiza respektive e kolegëve të tyre nga ana e BE-së, pasi që të gjitha takimet e strukturave të MSA-së janë anuluar si pasojë e masave të BE-së. Në kuptimin financiar, asistenca financiare e BE-së për Kosovën është pezulluara, duke vënë në suspansë asistencën vjetore të Instrumentit të Para-Anëtarësimit si dhe duke ia mohuar Kosovës të drejtën për aplikim fondesh në kuadër të Kornizës Investuese të Ballkanit Perendimor.

Një sfond i këtillë sfidues patjetër se nuk ka qenë i favorshëm për ndërmarrjen e reformave evropiane. Ne besojmë se në veçanti se një sfidim kaq serioz i sigurisë së Kosovës sikur ai i Banjskës ka obliguar institucionet e Kosovës që në interes të menaxhimit të çështjeve të sigurisë, të vendos planet e reformave evropiane në plan të dytë.

Tani duke e adresuar kontekstin e barometrit të këtij viti ka arritur koha që të bëjmë prezantimin e përmbledhur të rezultateve të barometrit.

Qeveria e Republikës së Kosovës përbëhet nga 15 ministri, plus Zyra e Kryeministrit. Tre nga këto ministri (Ministria e Jashtme, e Forcës dhe e Zhvillimit Rajonal) nuk janë pjesë e barometrit pasi që ato nuk kanë pasur obligime në kuadër të procesit integruar të Kosovës. Kështu na ngelin 13 ministritë (përfshirë Zyrën e Kryeministrit) të cilat përfundimisht kanë mbetur pjesë e barometrit.

Nga trembëdhjete ministritë, tetë ministri kanë treguar performansë të mirë dhe pesë ministri kanë treguar performansë të kufizuar.

Tetë ministri me performansë të mirë janë:

1. Ministria e Ekonomisë me 64 pikë;
2. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me 64 pikë;
3. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me 60 pikë;
4. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rajonal me 60 pikë;
5. Ministria e Punëve të Brendshme me 56 pikë;
6. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me 56 pikë;
7. Ministria e Drejtësisë me 53 pikë; dhe
8. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me 53 pikë.


Pesë ministri me performansë të kufizuar janë:

1. Ministria për Kthim dhe Komunitete me 46 pikë;
2. Ministria e Shëndetësisë me 45 pikë;
3. Zyra e Kryeministrit me 39 pikë;
4. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me 36 pikë; dhe
5. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me 29 pikë.

Në fund kjo ka rezultuar me vlerësimin përfundimtar të gjithë Qeverisë me 51 pikë totale, duke e vlerësuar kështu me performansë të mirë në ndërmarrjen e reformave evropiane gjatë vitit 2023.

Rangimi Evropian

Infografika e rangimit të ministrave sipas performansës



Ministria e Ekonomisë (ME)



64/100 pikë

Ministria e Ekonomisë (ME) i përket grupit të ministrive me performancë të mirë. Ajo ka fituar gjithsej 64 pikë nga totali prej 100 pikësh. ME karakterizohet me një planifikim të masave të kompleksitetit të lartë në kuadër të kornizës planifikuese të qeverisë dhe përpjekjet e saja për reforma ka vlerësuar pozitivisht edhe Raporti i Komisionit Evropian 2023. Nga ana tjetër, planifikimi i masave të ME-së në kuadër të kornizës planifikuese të qeverisë karakterizohet me një ndërlidhje të kufizuar në mes obligimeve në kuadër të agjendës evropiane dhe masave të planifikuara. Po ashtu, ME ka arritur progres të kufizuar në zbatimin e masave të planifikuara.

Vlerësimi për kriterin 1:

Kompleksiteti i masave të planifikuara

Sa i përket kriterit një, respektivisht kompleksiteti i masave, ME karakterizohet me masa të kompleksitetit të lartë. 92% e masave të ME-së janë cilësuar si masa komplekse. Pothuaj të gjitha masat e ME-së të parapara në kuadër të kornizës planifikuese të qeverisë janë specifike, të matshme dhe përbejnë reformë thelbësorë në sektorët përkatës. Masat e ME-së po ashtu janë pjesë e reformave kyçe të parapara me MSA dhe ERA. Në disa raste specifike ato edhe transpozojnë legjislacionin e BE-së dhe kërkojnë koordinim ndër-sektorial.

Vlerësimi për kriterin 2:

Planifikimi i masave vs obligimet evropiane

Sa i përket kriterit dy, respektivisht harmonizimi në mes planifikimit të masave me obligimet në kuadër të agjendës evropiane, ME karakterizohet me një shkallë të kufizuar të harmonizimit të planifikimit. 36% e obligimeve

në kuadër të agjendës evropiane janë të adresuara në kuadër të planifikimit të ME-së. Në ciklet e ardhshme të planifikimit ME duhet të sigurohet se planifikimi i saj adreson në veçanti zbatimin e fazës dytë të studimit gjithëpërfshirës për burimet të qëndrueshme alternative energjetike, zgjerimin e Fondit të Eficiencës së Energjisë për ndërtesat rezidenciale, si dhe ndërmarrjet të vogla dhe të mesme. Po ashtu, ME duhet të sigurohet se legjislacioni i Kosovës është i përafuar me Kodin Evropian të Komunikimit Elektronik, Direktivën Evropiane për Sigurinë e Rrjeteve dhe Informacionit dhe "toolbox-in" e BE-së për sigurinë kibernetike 5G.

Vlerësimi për kriterin 3:

Zbatimi i masave të planifikuara

Sa i përket kriterit tre, respektivisht nivelit të zbatimit të masave të planifikuara, ME karakterizohet me një shkallë të kufizuar të zbatimit. 46% e masave të parapara për vitin 2023 janë zbatuar. Ndër tjera, ME duhet të siguroj miratimin e Planit të Energjisë dhe Klimës 2021-2030 dhe Rregullores për Skemën e re Mbështetëse për BRE.

Vlerësimi për kriterin 4:

Vlerësimi i Komisionit Evropian

Sa i përket kriterit katër, respektivisht vlerësimin të Raportit vjetor për Kosovën nga ana e Komisionit Evropian, ME ka marr vlerësim pozitiv prej 10 pikësh. Nën mandatin e ME-së bien dy kapituj vlerësimi: kapitulli 10 – Transformimi digjital dhe media dhe kapitulli 15: Energjia. Në vitin 2023, KE ka vlerësuar se në kapitullin 10, Kosova ka performuar më dobët se vitin e kaluar, ndërsa në kapitullin 15 më mirë se vitin e kaluar. Duke pas parasysh rëndësinë e kapitullit 15, si dhe ndërlidhjen më të fortë dhe drejtpërdrejtë të ME-së me kapitullin 15, se sa kapitullin 10, vlerësimi i ME-së në kuadër të këtij kriteri është pozitiv.

Kriteri 1: Kompleksiteti i masave

Ministritë planifikojnë masa të ndryshme në kuadër të Programit Kombëtar për Integrim Evropian dhe Agjendës së Reformës Evropiane. Në disa raste, këto masa janë relevante, të planifikuara mirë, strategjike, komplekse dhe të kujdesshme financiarisht. Në raste të tjera, ata nuk janë. Qëllimi i këtij vlerësimi është të bëjë dallimin ndërmjet masave të BE-së të planifikuara mirë dhe më pak të planifikuara mirë, duke shpërblyer kështu ministritë me performancë më të mirë.

Masat	Afati	Ref.	Specifike	E matshme	Reformë	Intensiteti i burimeve	Kompleksiteti ndërinstitucional	Nivelet e miratimit	Prioriteti i MSA-së dhe ERA-s	Masa përfiton Acquis	Ndieshmëria politike	Totali
Projektligji për energji, i miratuar	K4 2023	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Projektligji për rregullatorin e energjisë, i miratuar	K4 2023	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Projektligji për burimet e ripërtëritshme të energjisë, i miratuar	K2 2023	PKIE ERA (K4 2022)	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë, i miratuar	K3 2023	PKIE ERA (K2 2022)	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Plani i Energjisë dhe Klimës 2021-2030, i miratuar	K2 2022	ERA	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Rregullorja për skemën e re mbështetëse për BRE	K4 2022	ERA	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Dizajnimi i skemës konkurruese për BRE	K4 2022	ERA	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Hapja e tregut të energjisë për konsumatorët e nivelit të tensionit 35 kv dhe 10 kv	K2 2022	ERA	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Projektligji i plotësuar-ndryshuar për ndërmarrje publike, bazuar në rekomandimet e BE dhe praktikatat e mira, i miratuar	K2 2022	ERA	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Aktet nënligjore të miratuara	K4 2022	ERA	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Kodi i etikës dhe qeverisjes korporative të ndërmarrjeve publike, i miratuar	K3 2022	ERA	1	1	0	0	0	0	1	0	0	3
Agjenda Digjitale për Kosovën 2030, e miratua	K3 2023	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Njëzet (20) përgjije të rrjetit mobil, '5G ready', të lidhura me infrastrukturë fikse brezgjere	K4 2023	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Përqindja												92%
Rezultati i përgjithshëm												10

Kriteri 2: Planifikimi vs obligimet evropiane

Obligimet specifike të Kosovës për BE-në janë të përshkruara në Raportin e BE-së për vendin dhe në konkluzionet e shtatë takimeve të nënkomitetit të MSA-së. Institucionet e Kosovës sigurojnë zbatimin e këtyre obligimeve duke përgatitur Programin Kombëtar për Integrim Evropian dhe Planin e Veprimit të Agjendës së Reformës Evropiane. Megjithatë, sfida është se shpesh ka një hendek midis këtyre dy realiteteve. Planifikimi nga ministritë e linjës shpesh nuk mbulon të gjitha detyrimet e specifikuar të BE-së. Prandaj, qëllimi i këtij vlerësimi është të bëjë dallimin ndërmjet planifikimit më shumë dhe më pak të kujdesshëm të detyrimeve të BE-së nga ministritë e linjës.

Obligimet evropiane	Masat që adresojnë obligimet evropiane	Vlerësimi
Miratimi i Strategjisë së Energjisë 2022-2031, në përputhje me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane dhe Axhendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, dhe për të siguruar konsistencën e saj me draft Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (T2/2022)	Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë, i miratuar	1
Progresi në finalizimin e Planit Kombëtar të Integruar të Energjisë dhe Klimës (K4/2022)	Plani i Energjisë dhe Klimës 2021-2030, i miratuar	1
Miratimi i Ligjit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë që prezanton një proces konkurrues tenderimi për projektet e energjisë së rinovueshme në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore (K4/2022)	Projektligji për burimet e ripërtëritshme të energjisë, i miratuar Dizajnimi i skemës konkurruese për BRE	1
Finalizimi i Agjendës Dixhitale të Kosovës 2030 [K2 2022].	Agjenda Digjitale për Kosovën 2030, e miratua	1
Në përputhje me tranzicionin e qëndrueshëm të gjelbër në Evropë, ndërmerrni fazën e dytë të studimit gjithëpërfshirës mbi burimet alternative të qëndrueshme të energjisë (K2/2022)		0
Përgatitja e dekomisionimit të pjesëve jofunkionale të Kosovës A, marrja e vendimit për tokën që do të caktohet për deponimin e mbeturinave të rrezikshme dhe përgatitja e një vlerësimi të ndikimit mjedisor dhe social me konsultimin e duhur publik me qëllim marrjen e një vendimi përfundimtar për tokë (K2/2022)		0
Përfundoni punët shtesë në mbështetje të projektit të financuar nga BE-ja për Termocentralin Kosova B (T3/2022 Njësia B2, T3/2023 Njësia B1)		0
Marrja e masave për të planifikuar rimbushjen e Fondit të Eficiencës së Energjisë në baza vjetore dhe shtrirjen e tij në ndërtesat e banimit dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME) (T4/2022)		0
Miratimi i stimujve të efikasitetit të energjisë për sektorin privat dhe familjet duke u fokusuar në aspektet sociale dhe familjet me të ardhura të ulëta (stimujt shtetërorë) dhe shfrytëzimin e programeve ekzistuese të BE-së në Kosovë (K4/2022).		0
Përfundoni përafrimin e legjislacionit të Kosovës me Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike, Direktivën e BE-së për Sigurinë e Rrjetit dhe Informacionit dhe Kutinë e Veglave të BE-së për sigurinë kibernetike 5G		0
Përgatitja e programit për mbrojtjen e konsumatorëve të ndjeshëm dhe përgatitja e një plani dhe masash zbutëse për të mbështetur këta konsumatorë		0
Përqindja		36%
Rezultati i përgjithshëm		4

Kriteri 3: Shkalla e zbatimit

Qëllimi i këtij vlerësimi është të matë zbatimin e masave të planifikuara në Programin Kombëtar për Integrim Evropian dhe Planin e Veprimit të Agjendës së Reformës Evropiane.

Masa	Afati	Referenca	Zbatimi
Projektligji për energji, i miratuar	K4 2023	PKIE	1
Projektligji për rregullatorin e energjisë, i miratuar	K4 2023	PKIE	1
Projektligji për burimet e ripërtëritshme të energjisë, i miratuar	K2 2023	PKIE ERA (K4 2022)	1
Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë, i miratuar	K3 2023	PKIE ERA (K2 2022)	1
Plani i Energjisë dhe Klimës 2021-2030, i miratuar	K2 2022	ERA	0
Rregullorja për skemën e re mbështetëse për BRE	K4 2022	ERA	0
Dizajnimi i skemës konkurruese për BRE	K4 2022	ERA	0
Hapja e tregut të energjisë për konsumatorët e nivelit të tensionit 35 kv dhe 10 kv	K2 2022	ERA	0
Projektligji i plotësuar-ndryshuar për ndërmarrje publike, bazuar në rekomandimet e BE dhe praktikatat e mira, i miratuar	K2 2022	ERA	0
Aktet nënligjore të miratuara	K4 2022	ERA	0
Kodi i etikës dhe qeverisjes korporative të ndërmarrjeve publike, i miratuar	K3 2022	ERA	0
Agjenda Digjitale për Kosovën 2030, e miratuar	K3 2023	PKIE	1
Njëzet (20) pirgje të rrjetit mobil, '5G ready', të lidhura me infrastrukturë fikse brezgjere	K4 2023	PKIE	1
Përqindja			46%
Rezultati i përgjithshëm			5

Kriteri 4: Vlerësimi i raportit të vendit i BE-së

Çdo vit Komisioni Evropian publikon raportin vjetor të vendit për Kosovën. Në raport, KE përdor metodologji të matshme që lejon matjen e progresit vjetor të vendit në miratimin e detyrimeve të anëtarësimit në BE sipas përkrahimit të mëposhtëm: (0) kthim prapa; (1) nuk ka përparim; (2) progres i kufizuar; (3) disa përparime; (4) progres i mirë; (5) progres shumë i mirë. Qëllimi i këtij vlerësimi është të faktorizojë progresin që ka bërë çdo ministri e linjës gjatë periudhës së vlerësimit.

Kapitulli i raportit të vendit i BE-së

Vlerësimi i raportit të vendit i BE-së

Kapitulli 15: Energjia	10
Kapitulli 10: Transformimi digjital dhe mediat	-10
Rezultati i përgjithshëm	10

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)



64/100 pikë

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) i takon grupit të ministrive me performancë të mirë. Ajo është vlerësuar me 64 pikë nga totali prej 100 pikësh. Shumica e masave të planifikuara për vitin 2023 ishin të një kompleksiteti të lartë. Për më shumë, sa i takon zbatimit, kjo ministri ka performuar mirë, me shkallë prej 72% brenda vitit 2023. Në anën tjetër, sa i takon ndërlidhjes me obligimet e agjendës evropiane, ministria ballafaqohet me një shkallë të kufizuar të kësaj ndërlidhjeje. Njëkohësisht, vlerësimi për MMPHI nga ana e Komisionit Evropian në vitin 2023 mbetet i njëjtë si në vitin paraprak.

Vlerësimi për kriterin 1:

Kompleksiteti i masave të planifikuara

Sa i përket kriterit një, respektivisht kompleksiteti i masave, MMPHI karakterizohet me masa të kompleksitetit të lartë. 83% e masave të ministrisë janë cilësuar si masa komplekse. Shumica e masave të planifikuara të MMPHI konsiderohen specifike dhe të matshme. Këto masa paraqesin gjithashtu edhe reforma kyçe të parapara me MSA dhe ERA. Një numër masash transpozojnë legjislacionin e BE-së dhe shumica kanë kërkesa të larta buxhetore si dhe kërkojnë koordinim ndër-institucional.

Vlerësimi për kriterin 2:

Planifikimi i masave vs obligimet evropiane

Sa i përket kriterit dy, respektivisht harmonizimi në mes planifikimit të masave me obligimet në kuadër të agjendës evropiane, MMPHI karakterizohet me një shkallë të kufizuar të harmonizimit të planifikimit. 49% e obligimeve në

kuadër të agjendës evropiane janë të adresuara në kuadër të planifikimit të MMPHI-së. Në ciklet e ardhshme të planifikimit MMPHI duhet të adresojë në veçanti kërkesat e Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, sidomos sa i takon përdorimit të karburanteve alternative, zbatimit të Planit të Veprimit Rajonal për Sigurinë Rrugore, si dhe zhvillimin e një Strategjie për Sigurinë në Rrugë. Për më tepër, sa i takon mjedisit, duhet adresuar edhe kërkesat rreth përfshirjes në kuadër ligjor të parimit ndotësi paguan, duhet harmonizuar kornizën ligjore dhe strategjike vendore me Agjendën e Gjellbër të Ballkanit Perëndimor, sigurimin e masave efektive për mbrojtjen e specieve të rrezikuara, zbatimin e plotë të kornizës strategjike të ndryshimeve klimatike, si dhe zhvillimin e një strategjie afat-gjatë të dekarbonizimit.

Vlerësimi për kriterin 3:

Zbatimi i masave të planifikuara

Sa i përket kriterit tre, respektivisht nivelit të zbatimit të masave të planifikuara, ME karakterizohet me një shkallë të konsoliduar të zbatimit. 72% e masave të parapara për vitin 2023 janë zbatuar. Duke shikuar përpara ndër masat më të rëndësishme që nuk janë përfunduar brenda vitit 2023 dhe ngelin për të ardhmen janë zhvillimi i Strategjisë së Mbrojtjes së Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, miratimi i Ligjit për Ujëra, si dhe zhvillimi i kapaciteteve inspektuese.

Vlerësimi për kriterin 4:

Vlerësimi i Komisionit Evropian

Sa i përket kriterit katër, respektivisht vlerësimin të Raportit vjetor për Kosovën nga ana e Komisionit Evropian, MMPHI nuk ka marr pikë shtesë. Nën mandatin e MMPHI-së bien dy kapituj vlerësimi: kapitulli 14 – Politikat e transportit dhe kapitulli 27 – Mjedisi dhe ndryshimet klimatike. Në vitin 2023, KE ka vlerësuar se në kapitullin 14, Kosova ka performuar më dobët se vitin e kaluar, ndërsa në kapitullin 27 nuk ka pasur ndryshim krahasuar me vitin e kaluar. Duke pas parasysh rëndësinë dhe vëllimin e kapitullit 27, si dhe ndërlidhjen më të fortë dhe drejtpërdrejtë të MMPHI-së me kapitullin 27, se sa kapitullin 15, vlerësimi i MMPHI-së ngelet neutral në kuadër të këtij kriteri.

Kriteri 1: Kompleksiteti i masave

Ministritë planifikojnë masa të ndryshme në kuadër të Programit Kombëtar për Integrim Evropian dhe Agjendës së Reformës Evropiane. Në disa raste, këto masa janë relevante, të planifikuara mirë, strategjike, komplekse dhe të kujdeshme financiarisht. Në raste të tjera, ata nuk janë. Qëllimi i këtij vlerësimi është të bëjë dallimin ndërmjet masave të BE-së të planifikuara mirë dhe më pak të planifikuara mirë, duke shpërblyer kështu ministritë me performancë më të mirë.

Masat	Afati	Ref.	Specifike	E matshme	Reformë	Intensiteti i burimeve	Kompleksiteti ndërinstitucional	Nivelet e miratimit	Prioriteti i MSA së dhe ERA-s	Masa përfaqëson Acquis	Najshmëria politike	Totali
Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Transportin Rrugor, i miratuar	K4 2023	PKIE	1	1	1	0	1	1	0	1	0	6
UA për kontrollimin e rregullsisë teknike të automjeteve në rrugë, i miratuar	K2 2023	PKIE	1	1	0	0	0	0	0	1	0	3
Plani i veprimit 2023-2025 për zbatimin e Strategjisë së transportit multimodal 2023-2030, i miratuar	K4 2023	PKIE	1	1	1	1	1	1	0	0	0	6
Koncept dokumenti për hekurudha, i miratuar	K4 2023	PKIE	1	1	1	0	1	0	1	0	0	5
Koncept dokumenti për transportin e mallrave të rrezikshme, i miratuar	K3 2023	PKIE	1	1	1	0	1	0	1	0	0	5
Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, i miratuar	K3 2023	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Projektligji për ndryshime klimatike, i miratuar	K2 2023	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Projektligji për inspektimin në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe banimit, i miratuar	K4 2023	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
UA për ambalazhim/paketim dhe mbeturinat e ambalazhimit/ paketimit, i miratuar	K2 2023	PKIE	1	1	1	0	1	0	1	1	0	6
Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillim të Qëndrueshëm 2022-2030, e miratuar	K3 2023	PKIE /ERA	1	1	1	0	1	0	1	0	0	5
Strategjia Shtetërore e Ujërave të Kosovës 2023-2027 dhe Plani i Veprimit 2023-2025 për zbatimin e saj, i miratuar	K2 2023	PKIE /ERA	1	1	1	0	1	0	1	0	0	5
Koncept dokumenti për fushën e ujërave, i miratuar	K2 2023	PKIE	1	1	1	0	1	0	1	0	0	5
Koncept dokumenti për fushën e mbrojtjes së natyrës, i miratuar	K3 2023	PKIE	1	1	1	0	1	0	1	0	0	5
Plani për menaxhimin e mbeturinave ndërtimore dhe të demolimit, i miratuar	K2 2023	PKIE /ERA	1	1	1	0	1	1	1	0	0	6
Numri i inspektorëve të trajnuar për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit mjedisor	K4 2023	PKIE /ERA	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Numri i zonave të reja të natyrës (rreth 10), të mbrojtura	K4 2023	PKIE /ERA	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Numri i deponive ilegale në komuna të identifikuara dhe reduktuara	K3 2023	PKIE /ERA	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Inventari i gazrave serrë për vitin 2021, i përgatitur	K2 2023	PKIE	1	1	1	1	1	0	0	0	0	5
Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, i miratuar	K1 2022	ERA	1	1	1	1	0	1	1	1	0	7
Projektligji për ujërat e Kosovës, i miratuar	K1 2022	ERA	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Projektligji për mbeturinat, i miratuar	K2 2021	ERA	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Fillimi i hartimit të strategjisë për dekarbonizim	K4 2021	ERA	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Plani i rishikuar kombëtar për cilësinë e ajrit, i miratuar	K4 2022	ERA	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7

Plani për menaxhimin e mbeturinave me VSM në zonën e Prishtinës, i hartuar	K2 2023	ERA	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Plani i menaxhimit për pellgun e lumit Drini i Bardhë, i finalizuar	K4 2022	ERA	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Rrjeti i monitorimit të ujërave nëntokësore, i funksionalizuar	K4 2022	ERA	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Trajnimi i nivelit komunal për zbatimin e legjisllacionit për menaxhimin e mbeturinave	K4 2022	ERA	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Fillimi i zbatimit të projekteve për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme: objektin për ruajtjen e përkohshme të mbetjeve të rrezikshme, dekomisionimi i Kosovës A	K3 2021	ERA	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Qendrat e transferimit dhe riciklimit në Skenderaj, Klinë, Istog, Novobërdë, të ndërtuara	K2 2023	ERA	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Fillimi i krijimit të sistemit të rikthimit të depozitës për shishe, plastikë dhe kanaçe	K4 2022	ERA	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Plotësim-ndryshimi i Ligjit nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës	K3 2021	ERA	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Monitorimi dhe raportimi për gjendjen e zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit	K4 2022	ERA	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Plani hapësinor për parkun kombëtar 'Sharri', i miratuar	K2 2023	ERA	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Plani hapësinor i parkut kombëtar 'Bjeshkët e Nemuna', i miratuar	K2 2022	ERA	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Krijimi i Sistemit online të Informacionit Mjedisor	K1 2023	ERA	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Përqindja												83%
Rezultati i përgjithshëm												9

Kriteri 2: Planifikimi vs obligimet evropiane

Obligimet specifike të Kosovës për BE-në janë të përshkruara në Raportin e BE-së për vendin dhe në konkluzionet e shtatë takimeve të nënkomitetit të MSA-së. Institucionet e Kosovës sigurojnë zbatimin e këtyre obligimeve duke përgatitur Programin Kombëtar për Integrim Evropian dhe Planin e Veprimit të Agjendës së Reformës Evropiane. Megjithatë, sfida është se shpesh ka një hendek midis këtyre dy realiteteve. Planifikimi nga ministritë e linjës shpesh nuk mbulon të gjitha detyrimet e specifikuar të BE-së. Prandaj, qëllimi i këtij vlerësimi është të bëjë dallimin ndërmjet planifikimit më shumë dhe më pak të kujdesshëm të detyrimeve të BE-së nga ministritë e linjës.

Obligimet evropiane	Masat që adresojnë obligimet evropiane	Vlerësimi
Të investojë në mirëmbajtjen dhe inspektimet e rrugëve, të organizojë fushata parandaluese dhe të krijojë një mekanizëm monitorues sistematik për mbledhjen e të dhënave të aksidenteve;	Ligji për rrugët, I miratuar	1
Të transpozoi acquis të BE-së në tregun hekurudhor dhe miratimi i ligjit të ri për sigurinë dhe ndëroperueshmërinë hekurudhore;	Ligji për siguri hekurudhore, I miratuar	1
Të miratojë strategjinë për transportin multimodal, e cila duhet të përfshijë ndër të tjera strategjinë e aviacionit civil; vazhdoj përpjekjet për të harmonizuar rregulloren e aviacionit të Kosovës me Marrëveshjen për Zonën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit;	Plani i veprimit 2023-2025 për zbatimin e Strategjisë së transportit multimodal 2023-2030, i miratuar	1
Të miratojë strategjinë e sistemit inteligjent të transportit (ITS) dhe planin e veprimit, të sigurojë kapacitet dhe burime të mjaftueshme për zbatim dhe të vazhdojë përpjekjet për të harmonizuar me acquis të BE-së të drejtat e pasagjerëve në të gjitha llojet e transportit.	Strategjia e sistemit inteligjent të transportit (ITS), e miratuar	1
Në fushën e sigurisë rrugore, Kosova duhet të vazhdojë harmonizimin e legjisllacionit me acquis të BE-së në fushën e edukimit, fushatave ndërgjegjësuese, zbatimit të aktiviteteve për të arritur rezultate më të mira në përputhje me qëllimet e Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian për të përgjysmuar numri i vdekjeve dhe lëndimeve në rrugë deri në vitin 2030.	Plani i veprimit për siguri rrugore miratuar në tetor 2020 është përfshirë në programin nacional për siguri rrugore dhe planin e veprimit 2023-2030.	1

Përditësimi i Strategjisë të Transportit Multimodal për të përfshirë elementë të qëndrueshëm dhe të zgjuar, në përputhje me Strategjinë e Lëvizshmërisë së Qëndrueshme dhe të Zgjuar të BE-së dhe BP-së, Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane dhe Axfordën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (K4/2022).	Plani i veprimit 2023-2025 për zbatimin e Strategjisë së transportit multimodal 2023-2030, i miratuar	1
Miratimi i 'Udhëzimi Administrativ për Kornizën për vendosjen e sistemet inteligjente të transportit (ITS)' (K2/2022).	Udhëzimi administrativ për ITS, i miratuar	1
Të bëhen përpjekje për të filluar transpozimin e acquis të BE-së për transportin rrugor. (e vazhdueshme)	Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Transportin Rrugor, i miratuar	1
Miratimi i Strategjisë Sektoriale të Transportit Multimodal që përfshin aviacionin civil strategjia (K4/2022)	Strategjia e transportit multimodal 2023-2030	1
Kosova duhet të rrisë angazhimin e saj politik për të adresuar degradimin e mjedisit dhe sfidat e ndryshimeve klimatike dhe të përmirësojë ndjeshëm zbatimin e legjislativitetit të saj, për ta harmonizuar atë me Agjendën e Gjelbër për qëllimet e Ballkanit Perëndimor;	Projektligji për Ndryshime Klimatike është miratuar në Qeveri me datën 12.07.2023 me vendim Nr. 02/151.	1
Të trajtojnë në mënyrë efektive çështjen e venddepozitimeve të paligjshme dhe të prezantojnë masat e ekonomisë rrethore për reduktimin e mbetjeve, zhvillimin dhe miratimin e planeve ndërkomunale të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe krijimin e prodhuesve të zgjeruar sistemi i përgjegjësisë;	Numri i deponive ilegale në komunat e Kosovës, të identifikuar dhe reduktuar	1
Kosova gjithashtu duhet të ndryshojë dhe zbatojë ligjet për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe strategjik	Projektligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, i miratuar	1
Kosova duhet të rrisë kapacitetet në të gjitha nivelet dhe të përcaktojë objektiva dhe afate kohore reale për të siguruar zbatimin efektiv të menaxhimit të saj të integruar të mbeturinave dhe ekonomisë rrethore;	Udhëzimi Administrativ për Ambalazh/paketimit dhe mbeturinat e ambalazhimit/paketimit, i miratuar	1
Autoriteti i pellgut lumor duhet të bëhet funksional si çështje urgjente;	Autoritetit Rajonal i Pellgjeve Lumore është funksional me Rregulloren (qrk)-nr. 05/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të ministrisë së mjedisit dhe planifikimit hapësinor e miratuar me 13 qershor 2017	1
Miratimi i Ligjit për ndryshimet klimatike (K4/2022)	Projektligji për ndryshime klimatike, i miratuar	1
Forcimi në mënyrë të konsiderueshme dhe urgjente i kapaciteteve administrative (në vazhdimësi) dhe raport tremujor mbi progresin	Numri i inspektorëve të trajnuar për të kontrolluar zbatimin e legjislativitetit mjedisor	1
Përgatitja e një inventar9 të emetimeve të gazeve serrë që mbulojnë deri në vitin 2020 (K2/2022).	Inventari i gazrave serrë për vitin 2021, i përgatitur	1
Miratimi i Ligjit të ndryshuar për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (T4/2022).	Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, i miratuar	1
Miratimi i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja (K2/2022).	Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja është miratuar në Kuvend me 23.06.2022 dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare me 07.07.2023	1
"Miratimi i Projektligjit për Themelimin e Informacionit Hapësinor Kombëtar Infrastruktura (INSPIRE) (K2/2022)."	Ligji për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës është miratuar në Kuvend me 14.06.2022 dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare me 28.06.2023	1
"Finalizimi i krijimit të rrjetit të monitorimit të ujërave nëntokësore për të gjithë territorin dhe filloni mbledhjen e të dhënave. (K4/2022)."	Është krijuar rrjeti i monitorimit të ujërave nëntokësore, i cili aktualisht përmban 40 stacione monitoruese në të gjithë territorin e Kosovës. Në stacionet e monitorimit, në të gjitha pellgjet, janë instaluar sensorë për matjet hidrometrike, të cilët njëkohësisht matin dhe ruajnë të dhënat në mënyrë të përhershme gjatë gjithë vitit. Monitorimi i cilësisë fiziko-kimike të ujërave nëntokësore deri më tani është bërë vetëm në 3 pellgjet lumore: Ibër, Lepenc dhe Morava e Binces, dhe ky lloj monitorimi është bërë për herë të parë në Kosovë në maj të vitit 2023 (T2/ 2023). I njëjti monitorim është përsëritur edhe në tetor 2023. Monitorimi do të vazhdojë edhe në të ardhmen.	1

Miratorimi i Projektligjit për Ujërat e Kosovës dhe aktet nënligjore për Kushtet, Mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të zeza në publik Rrjeti i Kanalizimeve dhe në Trupin Ujor (K3/2022)	Koncept dokumenti për fushën e ujërave, i miratuar	1
Hartimi i Koncept Dokumentit për Mbrojtjen e Natyrës (K4/2022)	Koncept dokumenti për fushën e mbrojtjes së natyrës, i miratuar	1
“Ndrysho Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis sipas standardeve të BE-së përfshirja e komponentit social (K2/2022)”	Projektligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis është miratuar në Kuvend me 15 dhjetor 2022.	1
Miratimi i Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”, (K2/2023) dhe miratimi i Planit Hapësinor “Bjeshkët e Nemuna” (K4 2022)	Më 07.06.2023 Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka miratuar dokumentin e Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.	1
Miratimi i projektligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes (K2/2022).	Ligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes, i miratuar në Kuvendin e Kosovës me datën 08.03.2023 (nuk ka qene i planifikuar në PKIE 2023)	1
Të rrisë mbulimin e grumbullimit të mbetjeve, të zbatojë reduktimin e gjerë, ndarjen e riciklimit dhe ripërdorimin e mbetjeve,	Fillimi i krijimit të sistemit të rikthimit të depozitës për shishe, plastikë dhe kanaçe	1
Të zbatohet strategjia e ndryshimeve klimatike dhe planin e veprimit për ndryshimet klimatike;	Plani i Veprimit të Strategjise për Ndryshime Klimatike	1
Planet e cilësisë së ajrit për zonat në të cilat nivelet e ndotësve tejkalojnë qartë vlerat kufitare duhet të miratohen;	Plani i rishikuar kombëtar për cilësinë e ajrit, i miratuar	1
Monitorimi dhe menaxhimi efektiv i zonave të mbrojtjes së ujit duhet ende të përmirësohet. Një sistem efektiv monitorimi i ujit, me të dhëna të disponueshme për publikun, duhet të ngrihet urgjentisht.;	Krijimi i Sistemit online të Informacionit Mjedisor	1
Fillimi i hartimit të një strategjie afatgjatë të dekarbonizimit (K1/2022)	Fillimi i hartimit të strategjisë për dekarbonizim	1
Miratimi i Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm 2022- 030 (K4/2022)	Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillim të Qëndrueshëm 2022-2030, e miratuar	1
Miratimi i Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit (K4/2022) dhe planin e cilësisë së ajrit për Prishtinën (K3/2022)	Plani i rishikuar kombëtar për cilësinë e ajrit, i miratuar	1
Zhvillimi dhe fillimi i zbatimit të planit gjithëpërfshirës të zhvillimit të kapaciteteve institucionale për zbatimin dhe zbatimin e legjislationit për menaxhimin e mbetjeve.	Trajnimi i nivelit komunal për zbatimin e legjislationit për menaxhimin e mbeturinave	1
Fillimi i përgatitjes së programeve të parandalimit të mbetjeve (K2/2022)	Fillimi i zbatimit të projekteve për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme: objektin për ruajtjen e përkohshme të mbetjeve të rrezikshme, dekomisionimi i Kosovës A	1
Miratimi i planit të menaxhimit “Drini i Bardhë” (K3/2022) dhe identifikimi dhe monitorimi i të tjerave. zonat e rrezikut në lidhje me ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore dhe raportin mbi gjendjen e lojës dhe masat e propozuara korigjuese (K4/2022)	Plani i menaxhimit për pellgun e lumit Drini i Bardhë, i finalizuar	1
Fillimi i hartimit të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (K1/2023)	Plotësim-ndryshimi i Ligjit nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës	1
Miratimi dhe hartimi i planeve të detajuara rregulluese për Parkun Kombëtar Sharri dhe për Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” (K2/2022)	Plani hapësinor i parkut kombëtar ‘Bjeshkët e Nemuna’, i miratuar	1
Finalizimi i hartimit të planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore për trupat ujorë të mbetur (d.m.th. Ibër, Morava e Binçës dhe Lepenc) (K2/2024)		0
Kosova duhet të fillojë të synojë dhe zgjeroj përdorimin e karburanteve alternative, në përputhje me Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor dhe Strategjinë e Mobilitetit të Zgjuar dhe të Qëndrueshme për Ballkanin Perëndimor.		0
Duhet të fillojë puna për krijimin e Agjencisë së Sigurisë Rrugore dhe zhvillohet një Strategji gjithëpërfshirëse e Sigurisë Rrugore për 2022-2030, duke përfshirë vendosjen e objektivave dhe mbledhjen e të dhënave më të besueshme të aksidenteve.		0

Kosova duhet të zbatojë rekomandimet e raportit CONNECTA për të përmirësuar cilësinë e rrjetit rrugor dhe veprimet, siç janë përcaktuar në planin rajonal të veprimit të Traktatit të Komunitetit të Transportit për sigurinë rrugore.	0
Kosova duhet të sigurojë nënshkrimin dhe zbatimin e marrëveshjes financiare 2020-2024 me INFRAKOS, - Menaxherin e infrastrukturës hekurudhore.	0
Sektori i aviacionit vazhdon të përballet me një numër sfidash që dalin nga mos anëtarësimi i Kosovës në disa organizata ndërkombëtare të aviacionit civil.	0
Kosova duhet të vazhdojë harmonizimin me pikat e mbetura të fazës së parë të HPEA.	0
Së paku dhjetë (10) zyrtarë të fushës së sigurisë së produkteve, të trajnuar	K3 2023	PKIE	1
Standardi EN ISO/IEC 17020 për laboratorët e metrologjisë ligjore (laboratori i masës, laborator i vëllim rrjedhje, laborator i matjeve elektrike dhe laborator i presionit), i zbatuar	K4 2023	PKIE	1
UA për biokarburante, i miratuar	K2 2022	ERA	0
Sistemi online për shitjen e standardeve, i funksionalizuar	K4 2023	PKIE	1
Projektligji për regjistrin e pronarëve përfitues, i miratuar	K4 2023	PKIE	1
Projektligji për shoqëritë tregtare, i miratuar	K4 2023	PKIE	1
Së paku dy (2) sektorë të ri të shërbimeve, të digjitalizuar	K4 2023	PKIE	1
Ueb-faqja për pikën e vetme të kontaktit, e krijuar dhe e lansuar	K4 2023	PKIE	1
Strategjia për zhvillimin e industrisë dhe mbështetje të biznesit, e miratuar	K1 2023	PKIE	1
Agjencia për përkrahjen e ndërmarrjeve, e themeluar dhe funksionalizuar	K3 2023	PKIE	0
Analiza e ndikimit të zonave ekonomike në zhvillimin e NVM, e kryer	K4 2023	PKIE	1
Së paku dyzet (40) biznese përfituese të granteve që u ndihmojnë bizneseve për të rritur kapacitetet prodhuese dhe zbatojnë standardet e kërkuara në tregun e BE -së	K4 2023	PKIE	1
Së paku 20 biznese (10 deri në K2 2022 dhe 10 deri në K2 2023) të subvencionuara në formë të granteve për certifikim të produkteve	K2 2023	ERA	1
Struktura organizative e KIESA-së e miratuar e cila adreson aspektet kryesore të përmirësimit të performancës: ndarjen e përgjegjësive, burimeve financiare dhe kapaciteteve njerëzore	K2 2022	ERA	0
Mekanizmi i ankesës, i krijuar	K1 2022	ERA	0
Programi i kujdesit, i miratuar	K4 2022	ERA	0
Njësia e kujdesit për investitorët, e themeluar	K1 2022	ERA	0
Vlerësimi i performancës së skemave mbështetëse për bizneset të KIESA-s, i realizuar	K4 2022	ERA	0
Skema e Akreditimit për trupat certifikuese (EN ISO/IEC 17065) e themeluar dhe e funksionalizuar	K1 2022	ERA	0
Së paku dy (2) zyrtarë të rekrutuar në Agjencinë e Metrologjisë	K4 2022	ERA	0

Së paku një (1) laborator i ri në Agjencinë e Metrologjisë i themeluar	K4 2022	ERA	1
Njësia për informimin e bizneseve në lidhje me standardet e themeluar	K4 2022	ERA	1
Pika e vetme e kontaktit, e themeluar dhe e funksionalizuar	K1 2022	ERA	0
UA mbi kërkesat e përcaktuara në relacion me komunikimin tregtar përfshi reklamimin apo marketingun, i miratuar	K4 2023	PKIE	1
Programi për pronësi industriale, e miratuar	K1 2023	PKIE	0
Së paku tre (3) trajnime për zyrtarët e Agjencisë së Pronësisë Industriale, të realizuara	K4 2023	PKIE	1
Së paku një (1) produkt i regjistruar sipas treguesit gjeografik	K4 2023	PKIE	1
Dokumenti për politika tregtare, i miratuar	K3 2023	PKIE	0
Një (1) zyrtar në Departamentin e Tregtisë, i rekrutuar	K3 2023	PKIE	1
Përqindja			61%
Rezultati i përgjithshëm			7

Kriteri 4: Vlerësimi i raportit të vendit i BE-së

Çdo vit Komisioni Evropian publikon raportin vjetor të vendit për Kosovën. Në raport, KE përdor metodologji të matshme që lejon matjen e progresit vjetor të vendit në miratimin e detyrimeve të anëtarësimit në BE sipas përshkrimit të mëposhtëm: (0) kthim prapa; (1) nuk ka përparim; (2) progres i kufizuar; (3) disa përparime; (4) progres i mirë; (5) progres shumë i mirë. Qëllimi i këtij vlerësimi është të faktorizojë progresin që ka bërë çdo ministri e linjës gjatë periudhës së vlerësimit.

Kapitulli i raportit të vendit i BE-së

Vlerësimi i raportit të vendit i BE-së

Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave	0
Kapitulli 2: Liria e lëvizjes për punëtorët	-10
Kapitulli 3: E drejta e themelimit dhe liria për të ofruar shërbime	
Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit	0
Kapitulli 6: E drejta e shoqërive tregtare	0
Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale	0
Kapitulli 20: Politika e ndërmarrjed dhe industrisë	10
Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit	0
Kapitulli 30: Marrëdhëniet e jashtme	0
Rezultati i përgjithshëm	10

Ministria e Drejtësisë (MD)



53/100 pikë

Ministria e Drejtësisë (MD) i përket grupit të ministrive me performancë të mirë. Ajo ka fituar gjithsej 53 pikë. Në kuadër të kornizës planifikuese të qeverisë në fushën e integritimit Evropian MD karakterizohet me një planifikim të masave të kompleksiteti shumë të lartë. Po ashtu, MD ka siguruar një zbatim të konsoliduar të masave të parapara në kuadër të vitit 2023. Sidoqoftë, nga ana tjetër vërehet se ekziston një mosharmonizim i ndjeshëm në mes planifikimit të masave nga ana e MD-së në kuadër të kornizës planifikuese të Qeverisë dhe obligimeve të MD-së në kuadër të agjendës evropiane. Ndonëse Raporti i BE-së ka vlerësuar përpjekjet e MD-së për të avancuar brenda kapitullit 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore, ai po ashtu ka konfirmuar se nuk ka pasur ndryshim krahasuar me vitin e kaluar.

Vlerësimi për kriterin 1:

Kompleksiteti i masave të planifikuara

Sa i përket kriterit një, respektivisht kompleksiteti i masave, MD cilësohet me masat e kompleksitetit të lartë. 100% e masave të ministrisë janë masa komplekse, specifike dhe të matshme. Shumica prej tyre përbëjnë reforma kyçe dhe listohen si prioritetet e MSA dhe ERA. Për më shumë se gjysmën e tyre nuk kërkohet intensitet i madh i burimeve mirëpo kërkohet harmonizimi me legjislacion evropian.

Vlerësimi për kriterin 2:

Planifikimi i masave vs obligimet evropiane

Sa i përket kriterit dy, respektivisht harmonizimi në mes planifikimit të masave me obligimet në kuadër të agjendës evropiane, MD karakterizohet me një shkallë

të ultë të harmonizimit të planifikimit. Vetëm 17% e obligimeve në kuadër të agjendës evropiane janë të adresuara në planifikimin e MD-së. Ministria duhet të sigurojë që në ciklet e ardhshme të adresojë zbatimin e strategjisë për sundimin e Ligjit dhe planit të veprimit, miratimin e strategjisë që ka në fokus reduktimin e numrit të lëndëve të grumbulluara në gjykatat në Kosovë, alokimin e fondeve të qëndrueshme dhe të përhershme për strehimoret si dhe pasurimin e vazhdueshëm të databazës të MD-së për evidentimin e rasteve të dhunës në familje.

Vlerësimi për kriterin 3:

Zbatimi i masave të planifikuara

Sa i përket kriterit tre, respektivisht nivelit të zbatimit të masave të planifikuara, MD është vlerësuar me një shkallë të konsoliduar të zbatimit. 67% e masave të parapara për vitin 2023 janë zbatuar. MD duhet të angazhohet në përgatitjen dhe aprovimin e Projektligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, si dhe në nënshkrimin e marrëveshjes për bashkëpunim juridik me Francën.

Vlerësimi për kriterin 4:

Vlerësimi i Komisionit Evropian

Në kuadër të kriterit të katërt, lidhur në vlerësimin e Raportit vjetor për Kosovën nga Komisioni Evropian, MD nuk ka marr pikë shtesë. Kjo për arsye sepse brenda kapitullit që bie nën mandatin e MD-së, respektivisht kapitulli 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore nuk ka pasur ndryshim në krahasim me vitin e kaluar.

Kriteri 1: Kompleksiteti i masave

Ministritë planifikojnë masa të ndryshme në kuadër të Programit Kombëtar për Integrim Evropian dhe Agjendës së Reformës Evropiane. Në disa raste, këto masa janë relevante, të planifikuara mirë, strategjike, komplekse dhe të kujdesshme financiarisht. Në raste të tjera, ata nuk janë. Qëllimi i këtij vlerësimi është të bëjë dallimin ndërmjet masave të BE-së të planifikuara mirë dhe më pak të planifikuara mirë, duke shpërblyer kështu ministritë me performancë më të mirë.

Masat	Afati	Ref.	Specifike	E matshme	Reformë	Intensiteti i burimeve	Kompleksiteti ndërinstitucional	Nivelet e miratimit	Prioriteti i MSA-së dhe ERA-s	Masa për afron Acquis	Ndeshmëria politike	Totali
Projektligji për plotësim - ndryshimin e Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, i miratuar	K4 2023	PKIE	1	1	1	0	1	1	1	1	0	7
Marrëveshja për bashkëpunim juridik me Francën, e nënshkrua	K4 2023	PKIE	1	1	0	0	0	1	1	1	0	5
Koncept dokumenti për realizimin e të drejtave civile përfshirë të drejtën e palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme, i miratuar	K2 2023	PKIE ERA (K2 2022)	1	1	1	0	1	1	1	0	0	6
Projektligji për mosmarrëveshjet administrative, i miratuar	K2 2022	ERA	1	1	1	1	0	0	1	1	0	6
Koncept Dokumenti për realizimin e të drejtave civile përfshirë të drejtën e palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme	K2 2022	ERA	1	1	1	0	1	1	1	0	0	6
Projektligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunën në baza gjinore, i miratuar	K4 2023	ERA	1	1	1	1	1	0	1	1	0	7
Përqindja												100%

Rezultati i përgjithshëm

10

Kriteri 2: Planifikimi vs obligimet evropiane

Obligimet specifike të Kosovës për BE-në janë të përshkruara në Raportin e BE-së për vendin dhe në konkluzionet e shtatë takimeve të nënkomitetit të MSA-së. Institucionet e Kosovës sigurojnë zbatimin e këtyre obligimeve duke përgatitur Programin Kombëtar për Integrim Evropian dhe Planin e Veprimit të Agjendës së Reformës Evropiane. Megjithatë, sfida është se shpesh ka një hendek midis këtyre dy realiteteve. Planifikimi nga ministritë e linjës shpesh nuk mbulon të gjitha detyrimet e specifikuar të BE-së. Prandaj, qëllimi i këtij vlerësimi është të bëjë dallimin ndërmjet planifikimit më shumë dhe më pak të kujdesshëm të detyrimeve të BE-së nga ministritë e linjës.

Obligimet evropiane	Masat që adresojnë obligimet evropiane	Vlerësimi
Implementation of the Strategy of Rule of Law and its Action Pplan	Edhe pse është miratuar, nuk përfshihet në PKIE dhe ERA.	1
To complete the drafting of the law on confiscation of unjustifiably acquired assets in compliance with the principles enshrined in the Constitution and the recommendations of the Venice Commission, without prejudice to the full implementation of the existing tools on criminal confiscation	Projektligji për plotësim - ndryshimin e Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, i miratuar	1
Komisioni u interesua për strategjinë e Kosovës për të zvogëluar numrin e lëndëve të pazgjdhura gjyqësore. Autoritetet kujtuan miratimin në qershor 2022 të një plani për të reduktuar diferencën e mbetur dhe shpjeguan se më shumë burime iu ndanë sistemit, duke përfshirë më shumë staf, dhe se ata po punojnë drejt funksionalizimit të Gjykatës Ekonomike (K2 2022);		0
Draft i ri për Drejtësinë Administrative		0
Zbatimi i Kodit të ri të Procedurës Penale (MD)		0

Zbatimi i Ligjit për Deklarimin e Pasurisë dhe sigurimi i burimeve të nevojshme njerëzore, financiare dhe logjistike për Agjencinë (MD, Kuvend)	0
Sigurimi i trajnimit të stafit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për mjetet e reja parandaluese kundër korrupsionit	0
Përparimi i shpejtë me krijimin e Fondit të Konfiskimit në funksion të mundësimit të ripërdorimit për qëllime sociale të parave dhe aseteve që rrjedhin nga aktivitetet kriminale	0
Të zbatohen rekomandimet e Projektit PECK III në lidhje me kuadrin operacional të AMSCA	0
Ndarja e fondeve të qëndrueshme dhe të përhershme për strehimoret, në mënyrë që funksionimi i tyre të jetë i qëndrueshëm dhe efikas	0
Forcimi i përgjegjësi të Koordinatorit Kombëtar për Dhunën në Familje. Sigurimi i furnizimit të vazhdueshëm të të dhënave nga të gjitha institucionet në bazën e integruar të të dhënave në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe zbatimi i sigurt i strategjisë dhe planit të veprimit për Dhuna në familje dhe Dhuna ndaj Grave	0
Të intensifikohet bashkëpunimi sistematik me IRMCT-në në funksion të marrjes së informacionit, provave dhe ndihmës së paçmuar në zgjidhjen e rasteve të krimeve të luftës në pritje dhe personave të zhdukur.	0
Përqindja	17%

Rezultati i përgjithshëm

2

Kriteri 3: Shkalla e zbatimit

Qëllimi i këtij vlerësimi është të matë zbatimin e masave të planifikuara në Programin Kombëtar për Integrim Evropian dhe Planin e Veprimit të Agjendës së Reformës Evropiane.

Masa	Afati	Referenca	Zbatimi
Projektligji për plotësim - ndryshimin e Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, i miratuar	K3 2023	PKIE	0
Marrëveshja për bashkëpunim juridik me Francën, e nënshkrua	K3 2023	PKIE	0
Koncept dokumenti për realizimin e të drejtave civile përfshirë të drejtën e palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme, i miratuar	K3 2023	PKIE	1
Projektligji për mosmarrëveshjet administrative, i miratuar	K4 2023	PKIE	1
Koncept Dokumenti për realizimin e të drejtave civile përfshirë të drejtën e palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme	K4 2023	ERA	1
Projektligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunën në baza gjinore, i miratuar	K4 2023	ERA	1
Përqindja			67%

Rezultati i përgjithshëm

7

Kriteri 4: Vlerësimi i raportit të vendit i BE-së

Çdo vit Komisioni Evropian publikon raportin vjetor të vendit për Kosovën. Në raport, KE përdor metodologji të matshme që lejon matjen e progresit vjetor të vendit në miratimin e detyrimeve të anëtarësimit në BE sipas përshkrimit të mëposhtëm: (0) kthim prapa; (1) nuk ka përparim; (2) progres i kufizuar; (3) disa përparime; (4) progres i mirë; (5) progres shumë i mirë. Qëllimi i këtij vlerësimi është të faktorizojë progresin që ka bërë çdo ministri e linjës gjatë periudhës së vlerësimit.

Kapitulli i raportit të vendit i BE-së

Vlerësimi i raportit të vendit i BE-së

Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

0

Rezultati i përgjithshëm

0

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)



53/100 pikë

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) i përket grupit të ministrive me performancë të mirë. Ajo ka fituar gjithsej 53 pikë. Në kuadër të kornizës planifikuese të qeverisë në fushën e integritit Evropian MFPT karakterizohet me një planifikim të masave mjaft komplekse. Po ashtu, MFPT ka siguruar një zbatim të konsoliduar të masave të parapara në kuadër të vitit 2023. Sidoqoftë, nga ana tjetër vërehet se ekziston një mosharmonizim i ndjeshëm në mes planifikimit të masave nga ana e MFPT-së në kuadër të kornizës planifikuese të Qeverisë dhe obligimeve të MFPT-së në kuadër të agjendës evropiane. Po ashtu, ndonëse Raporti i BE-së ka vlerësuar përpjekjet e MFPT-së brenda kapitujve nën përgjegjësinë e saj, sidoqoftë po ashtu raporti ka konfirmuar se nuk ka pasur ndryshim krahasuar me vitin e kaluar.

Vlerësimi për kriterin 1:

Kompleksiteti i masave të planifikuara

Sa i përket kriterit një, respektivisht kompleksiteti i masave, MFPT karakterizohet me planifikim të masave mjaft komplekse. 66% e masave të MFPT-së janë cilësuar me kompleksitet të lartë. Shumica e masave të MFPT-së janë specifike, të matshme dhe shumë prej tyre konsiderohen si reforma thelbësore në fushat që mbulon kjo ministri. Masat e MFPT-së po ashtu janë pjesë e reformave kyçe të parapara me MSA dhe ERA. Në shumë raste ato kërkojnë transpozim të legjisllacionit të Bashkimit Evropian dhe kërkojnë një nivel të lartë koordinimi ndër-sektorial për të siguruar zbatimin e tyre.

Vlerësimi për kriterin 2:

Planifikimi i masave vs obligimet evropiane

Sa i përket kriterit dy, respektivisht harmonizimi në mes planifikimit të masave me obligimet në kuadër të agjendës evropiane, MFPT karakterizohet me një shkallë të kufizuar të harmonizimit të planifikimit. 31% e obligimeve në kuadër të agjendës evropiane janë të adresuara në planifikimin MFPT-së. Në ciklet e ardhshme të planifikimit, MFPT duhet të sigurohet se planifikimi adreson përmirësimin e ekzekutimit të shpenzimit kapital, të rishikojë skemat ekzistuese sociale, si dhe të avancoj hartimin e Skemës së re të Asistencës Sociale. Po ashtu, MFPT duhet të përfshijë në planifikimin e saj hartimin dhe miratimin e disa projektligjeve, siç janë Projektligji për Shërbimet e Pagesave, Projektligjin për Financat e Pushtetit Lokal si dhe Projektligjin për Banka.

Vlerësimi për kriterin 3:

Zbatimi i masave të planifikuara

Sa i përket kriterit tre, respektivisht nivelit të zbatimit të masave të planifikuara, MFPT karakterizohet me një shkallë të konsoliduar të zbatimit. Më shumë se gjysma e masave të parapara, më saktësisht 63%, për vitin 2023 janë zbatuar. Ndër tjera, MFPT duhet të siguroj miratimin e Projektligjit për Skemën për Ndihamat Sociale, Projektligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, si plotësim-ndryshimin e Projektligjit për Prokurimin Publik, si dhe Projektligjin për Ndihamën Shtetërore dhe Projektligjin e Punës.

Vlerësimi për kriterin 4:

Vlerësimi i Komisionit Evropian

Sa i përket kriterit katër, respektivisht vlerësimin të Raportit për Kosovën për vitin 2023 të Komisionit Evropian, MFPT nuk ka marr pikë shtesë. Brenda mandatit të MFPT-së bien kapitulli 4 – Lëvizja e lirë e kapitalit, kapitulli 5 – Prokurimi publik, kapitulli 16 – Tatimet, kapitulli 17 – Politikat ekonomike dhe monetare, kapitulli 19 - Politikat sociale dhe punësimi dhe kapitulli 29 – Bashkimi doganor. Në këtë drejtim, raporti i BE-së i vitit 2023 nuk ka evidentuar ndryshim krahasuar me vitin e kaluar brenda këtyre kapitujve. Rrjedhimisht, MFPT nuk ka marr pikë shtesë në kuadër të këtij kriteri.

Kriteri 1: Kompleksiteti i masave

Ministritë planifikojnë masa të ndryshme në kuadër të Programit Kombëtar për Integrim Evropian dhe Agjendës së Reformës Evropiane. Në disa raste, këto masa janë relevante, të planifikuara mirë, strategjike, komplekse dhe të kujdeshme financiarisht. Në raste të tjera, ata nuk janë. Qëllimi i këtij vlerësimi është të bëjë dallimin ndërmjet masave të BE-së të planifikuara mirë dhe më pak të planifikuara mirë, duke shpërblyer kështu ministritë me performancë më të mirë.

Masat	Afati	Ref.	Specifike	E matshme	Reformë	Intensiteti i burimeve	Kompleksiteti ndërinstitucional	Nivelet e miratimit	Prioriteti i MSA-së dhe ERA-s	Masa përfaqëson Acquis	Ndjeshmëria politike	Totali
Numri i trajnimeve të mbajtura për Departamentin e Makros në MFPT dhe Njësinë për Monitorimin e NPve në ME përmes projektit rajonal të asistencë teknike të FMN-FAD të financuar nga BE	K4 2023	PKIE	1	0	0	1	1	0	1	0	0	4
Raportimi i rregullt gjashtëmuor i zbatimit të Planit të Veprimit të SMFP 2022-2024	K3 2023	PKIE	1	1	1	0	1	0	1	0	0	5
Raportimi i rregullt vjetor i zbatimit të Planit të Veprimit të SMFP 2022- 2024	K2 2023	PKIE	1	1	1	0	1	0	1	0	0	5
Hartimi i analizës së rreziqeve fiskale, përfshirë rreziqet që vijnë nga NP-të, e përfshirë në kornizën makro-fiskale, në dokumentet strategjike si KASH, ligji i buxhetit dhe PRE	K4 2023	PKIE	1	1	1	1	0	0	1	0	0	5
Raporte tremujore financiare dhe të performancës për të gjitha NP-të, të përgatitura	K4 2023	PKIE	1	1	0	1	1	0	1	0	0	5
Plani për Zbatimin e Skemës së Garantuar për të Rinj, i pilotuar	K4 2023	PKIE	1	1	1	1	0	0	1	0	0	5
Numri i grave të përfshira në masat aktive të tregut të punës, i rritur	K4 2023	PKIE	1	0	1	1	1	0	1	0	0	5
Numri inspektorëve të punës i rritur për 100 inspektorë shtesë	K4 2023	PKIE ERA (K4 2022)	1	1	1	1	0	0	1	0	0	5
Numri i inspektimeve nga Inspektorati i Punës, i rritur	K4 2023	PKIE	1	0	0	1	0	0	1	0	0	3
Skema e grantit për zanate	K4 2022	ERA	1	1	1	1	1	0	1	0	0	6
Projektligji për skemën e ndihmave sociale, i miratuar	K2 2022	ERA	1	1	1	1	1	1	0	0	0	6
Projektligji për sigurinë dhe shëndetin në punë, i hartuar dhe miratuar	K2 2021	ERA	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Projektligji i punës, i miratuar	K2 2022	ERA	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Sistemi i Teknologjisë së Informacionit të Inspektoratit të Punës, i themeluar	K4 2022	ERA	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Programi shtetëror për inkurajimin e investimeve në eficiencën e energjisë duke subvencionuar familjet dhe bizneset që investojnë në këtë fushë, i miratuar	K4 2022	ERA	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Projektligji për shërbimet e pagesave, i miratuar	K4 2023	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Koncept dokumenti për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, i miratuar	K1 2023	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Udhëzuesit për faktorët e rrezikut, të hartuar dhe miratuar	K4 2023	PKIE	1	1	0	0	0	1	1	0	0	4

Memorandum mirëkuptimi për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë mes NJIF dhe BQK, i nënshkruar	K4 2023	PKIE	1	1	0	0	0	1	1	0	0	4
Të paktën dy (2) aktiviteteve mbikëqyrëse të mentorimit, të zhvilluara	K4 2023	PKIE	0	1	0	0	0	0	1	0	0	2
Numri i ngritur i raporteve të pranuara të transaksioneve / aktiviteteve të dyshimta	K4 2023	PKIE	1	1	0	1	0	0	1	0	0	4
Metodologjitë për vlerësim të rrezikut, të rishikuara/hartuara	K3 2023	PKIE	1	1	0	1	0	0	1	0	0	4
Projekt -kodi për plotësim - ndryshimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë, i miratuar	K2 2023	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Luftimi i ekonomisë joformale dhe mashtrimit doganor përmes rritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet Doganës, agjencive të zbatimit të ligjit dhe institucioneve të tjera relevante, e matur përmes numrit të inspektimeve të realizuara, numri i operacioneve të ndërmarra, rezultatet e arritura	K4 2023	PKIE	1	1	1	1	1	0	1	0	0	6
Zhvendosja në pronë publike dhe funksionalizimi i plotë për së paku një (1) terminali doganor	K4 2023	PKIE	1	1	0	0	1	0	1	0	0	4
Koncept dokumenti për rishikimin e politikave tatimore, i miratuar	K2 2023	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Numri i aktiviteteve në kuadër të projekteve për përmirësimin e përmbushjes tatimore, i rritur	K4 2023	PKIE	1	0	0	1	1	0	1	0	0	4
Numri i kontroleve dhe vizitave përmbushëse të bazuara në rrezik, i rritur	K4 2023	PKIE	1	0	0	0	0	0	1	0	0	2
Numri i veprimeve të ndërmarra për të përmirësuar pajtueshmërinë tatimore	K2 2023	ERA	1	0	0	1	1	0	1	0	0	4
Projektligji për plotësim - ndryshimin e Ligjit për Prokurimin Publik, i miratuar	K1 2023	PKIE ERA (K1 2022)	1	1	1	1	1	1	1	1	0	8
Projektligji për plotësimndryshimin e Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës, i miratuar	K2 2023	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Komitetet e auditimit të brendshëm në të gjitha organizatat buxhetore, përfshirë edhe nivelin komunal, të themeluara	K2 2023	PKIE	1	1	1	1	1	0	1	0	0	6
Koncept Dokumenti për themelimin e një trupi fiskal të pavarur i miratuar pas konsultimit me palët e interesit përfshirë edhe BE-në	K4 2021	ERA	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Pesëdhjetë (50) sesione informuese për komunat, ministrinë e linjës, institucionet rregullative dhe atyre të drejtësisë	K2 2023	ERA	1	1	0	1	1	0	1	0	0	5
Numri i skemave të harmonizuara me Rregullat e Ndhmës Shtetërore	K1 2023	ERA	1	0	1	1	0	0	1	0	0	4
Projektligji për ndihmë shtetërore, i rishikuar	K4 2022	ERA	1	1	1	1	1	0	1	1	0	7
Rregullorja për Ndhmën Horizontale, e miratuar	K4 2022	ERA	1	1	0	0	0	1	1	1	0	5
Numri i skemave shtesë të njoftuara në DNSH	K4 2023	PKIE	1	1	0	0	0	0	1	0	0	3
Përqindja												66%
Rezultati i përgjithshëm												7

Kriteri 2: Planifikimi vs obligimet evropiane

Obligimet specifike të Kosovës për BE-në janë të përshkruara në Raportin e BE-së për vendin dhe në konkluzionet e shtatë takimeve të nënkomitetit të MSA-së. Institucionet e Kosovës sigurojnë zbatimin e këtyre obligimeve duke përgatitur Programin Kombëtar për Integrim Evropian dhe Planin e Veprimit të Agjendës së Reformës Evropiane. Megjithatë, sfida është se shpesh ka një hendek midis këtyre dy realiteteve. Planifikimi nga ministritë e linjës shpesh nuk mbulon të gjitha detyrimet e specifikuar të BE-së. Prandaj, qëllimi i këtij vlerësimi është të bëjë dallimin ndërmjet planifikimit më shumë dhe më pak të kujdesshëm të detyrimeve të BE-së nga ministritë e linjës.

Obligimet evropiane	Masat që adresojnë obligimet evropiane	Vlerësimi
Ministria e Financave duhet të vazhdojë të përfshijë një analizë gjithëpërfshirëse të rrezikut fiskal të të gjitha Ndërmarrjeve Publike (NP) në dokumentet e strategjisë fiskale dhe të rifillojë publikimin në faqen e internetit të MFLT-së të pasqyrave financiare tremujore të NP-ve.	Hartimi i analizës së rreziqeve fiskale, përfshirë rreziqet që vijnë nga NP-të, e përfshirë në kornizën makro-fiskale, në dokumentet strategjike si KASh, ligji i buxhetit dhe PRE	1
Miratimi (K4 2022) dhe zbatimi (vazhdimisht) i Planit të Veprimit 2022-2023 dhe finalizimi (K4 2023) Strategjia për Parandalimin dhe Luftën kundër Ekonomisë Informale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare dhe publikoni rregullisht raportet e zbatimit të tyre.	Koncept dokumenti për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, i miratuar	1
Miratimi i Ligjit të Prokurimit Publik, duke marrë parasysh komentet e Komisionit Evropian	Projektligji për plotësim - ndryshimin e Ligjit për Prokurimin Publik, i miratuar	1
“Përmirësimi i ndjeshëm i ndërgjegjësimit për rreziqet e pastrimit të parave/financimit të terrorizmit nga bizneset dhe profesionet e përcaktuara jofinanciare dhe ofrimi i dëshmimeve përmes të dhënave mbi raportet e marra të transaksioneve të dyshimta dhe ndjekjen ligjore nëpërmjet hetimeve dhe sanksioneve nga autoritetet	Numri i ngritur i raporteve të pranuar të transaksioneve / aktivitetëve të dyshimta	1
Përmirësimi i funksionimit të sistemit të KBFP përmes zbatimit më të mirë të rekomandimeve të raportit vjetor të KBFP, dhe veçanërisht (1) duke përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet drejtuesit të njësisë së sektorit publik, komitetit të auditimit dhe auditorit të brendshëm. Të forcohen kapacitetet e performancës së njësive të auditimit të brendshëm për të kryer mandatin e tyre, përtej pajtueshmërisë me rregullat dhe procedurat, në veçanti duke zhvilluar procedura për sigurimin e cilësisë. Vazhdimi i zgjerimit të komiteteve të auditimit të brendshëm në të gjitha organizatat buxhetore, duke përfshirë edhe nivelin komunal.	Komitetet e auditimit të brendshëm në të gjitha organizatat buxhetore, përfshirë edhe nivelin komunal, të themeluara	1
Ndryshimi i Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës, duke hequr detyrimin për kryerjen e auditimeve të rregullsisë çdo vit për të gjitha organizatat buxhetore.	Projektligji për plotësimndryshimin e Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës, i miratuar	1
Miratimi i Ligjit të Punës dhe akteve nënligjore përkatëse, në përputhje me acquis përkatëse të BE-së, duke përfshirë lejen e lehonisë dhe prindërore dhe mosdiskriminimin në punësim dhe politikën sociale [K4 2022]	Projektligji i punës, i miratuar	1
Të sigurojë që Inspektorati i Punës të ketë burime adekuate financiare dhe njerëzore për të përmbushur mandatin e tij	Numri inspektorëve të punës i rritur për 100 inspektorë shtesë	1
Miratimi i projektligjit për ndryshimin e Kodit Doganor të Kosovës dhe Kodit të Akcizave, për t'i harmonizuar më tej me legjislacionin dhe praktikën e BE-së.	Projekt-kodi për plotësim-ndryshimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë, i miratuar	1
Ulja e tarifave të ngarkuara për eksportuesit/importuesit, për përdorimin e terminaleve në brendësi të vendosura në infrastrukturën private dhe vazhdoni procesin e zhvendosjes në vendet në pronësi publike	Zhvendosja në pronë publike dhe funksionalizimi i plotë për së paku një (1) terminali doganor	1
Të forcojë më tej funksionet e menaxhimit të rrezikut të pajtueshmërisë së Administratës Tatimore në Menaxhimin e Rrezikut të Përputhshmërisë dhe kontrollet tatimore në sektorët e bazuar në rrezik (të vazhdueshme) dhe të publikojë rregullisht raportet e zbatimit të aplikimit të metodologjisë së Menaxhimit të Rrezikut të Përputhshmërisë dhe zbatimin e Strategjisë së Përmirësimit të Auditimit 2020-2022 (të vazhdueshme).	Numri i veprimeve të ndërmarra për të përmirësuar pajtueshmërinë tatimore	1
të sigurojë zbatimin e Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore për t'u përgatitur për pilotimin e skemës;	Plani për Zbatimin e Skemës së Garantuar për të Rinj, i pilotuar	1

të intensifikohen inspektimet në sektorët e punës me rrezik më të lartë dhe të zbatohen rregullat për shëndetin dhe sigurinë në punë për të siguruar uljen e aksidenteve në vendin e punës;	Numri i inspektimeve nga Inspektorati i Punës, i rritur	1
Sigurimi i stabilitetit makro-financiar, i cili është kusht për çdo disbursim të mbështetjes buxhetore, duke përfshirë monitorimin e vazhdueshëm të situatës së borxhit publik dhe masat adekuate të kontrollit nëse nivelet e borxhit publik vazhdojnë të rriten.		0
Zbatoni udhëzimet e synuara të politikave për Programin e Reformës Ekonomike të ofruara për Kosovën në Konkluzionet e Përbashkëta të Dialogut Ekonomik dhe Financiar ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë në maj 2022.		0
Të gjitha shpenzimet publike, duke përfshirë prokurimet, disbursimet për programin e rimëkëmbjes, programet e mbështetjes financiare ose ndihmën shtetërore, duhet të bëhen sipas parimeve të transparencës dhe mbikëqyrjes së shpenzimeve publike dhe kuadrit ligjor vendas.		0
Përmirësimi i ekzekutimit të shpenzimeve kapitale, veçanërisht në prezantimin e një mekanizmi të rishikimit të çmimeve për të përballuar sfidat e rritjes aktuale të çmimeve dhe rritja e zbatimit të Udhëzimit Administrativ (UA) 2019 për kriteret e përzgjedhjes dhe prioritizimit të projekteve kapitale, si dhe konkluzionet për zbatimin e rekomandimeve të PEFA dhe PIMA.		0
Të mos miratohen iniciativeat e reja pensionale dhe sociale pa u bërë rishikimi i skemave ekzistuese sociale dhe iniciativave të reja, veçanërisht pensionet e bazuara në kategori, siç është rënë dakord në udhëzimin e politikave ERP 1.		0
Draftimi i projektligjit të ri për statusin dhe përfitimet e personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të Axhendës së Reformës Pensionale të Qeverisë, me qëllim që të sigurohet trajtim i barabartë dhe të përmbahen shpenzimet sociale, të cilat do të përcaktojnë kriteret për t'u kualifikuar për aftësi të kufizuara.		0
Të sigurohet që fondi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) të shpenzohet në mënyrë të synuar dhe transparente, dhe të zbatohen masa mbrojtëse dhe mbikëqyrëse në ekzekutimin e fondit, duke përfshirë veprimet që synojnë rimbursimin e depozitave të AKP-së dhe ndikimin e mundshëm si detyrime buxhetore.		0
Të sigurohet një raport i detajuar mbi zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes/Rigjallërimit Ekonomik dhe bëni rregullisht publikisht informacionin mbi personat juridikë që marrin grante dhe ndihmë shtetërore (0
Zbatimi i rekomandimeve të analizës së thellë të kërkesave për personel dhe kompetencë në fushat kryesore të politikave të Bankës Qendrore, veçanërisht stabilitetin financiar dhe vazhdoni të zbatoni procedurat e punësimit dhe politikën e Bankës Qendrore të Kosovës për punësimin (të vazhdueshme).		0
Miratimi dhe zbatimi i projektligjit për mikrofinancat dhe institucionet financiare jobanka, duke marrë parasysh komentet e Komisionit Evropian		0
Miratimi dhe zbatimi i Ligjit për Bankat		0
Pas miratimit të ligjit për të drejtat pronësore të të huajve, të miratohen të gjitha aktet e nevojshme nënligjore duke përfshirë të drejtat reciproke.		0
Miratimi i ligjit të ri për shërbimet e pagesave që transponon Direktivën e Shërbimeve të Pagesave 2		0
Miratimi dhe zbatimi i një strategjie të re MFP e cila përfshin një komponent specifik të KBFP dhe merr parasysh studimin e SIGMA mbi Përgjegjshmërinë Menaxheriale si dhe integrimin e menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit të brendshëm në proceset e MFP. Konsultohuni me Komisionin Evropian		0
Avancimi me hartimin e Skemës së re të Asistencës Sociale të testuar me mjete, ndërkohë që ndahen përfitimet ekzistuese kategorike sociale dhe krijohet një mekanizëm për rishikimin vjetor të përfitimeve.		0

Rritja e kapaciteteve të Agjencisë së Punësimit duke rritur numrin e zyrtarëve të punësimit për të siguruar ndarje të arsyeshme të rasteve dhe duke rritur fondet e qeverisë për masa aktive të tregut të punës	0
Përdorimi i raportit të sigurimit të cilësisë dhe Barometrin e sapokrijuar të Tregut të Punës dhe Aftësive të Kosovës, ndër të tjera, për të avancuar a) politikëbërjen e bazuar në dëshmi dhe b) reformën e sektorit të AAP-së, në përputhje me nevojat e tregut të punës. Krijimi i një dialogu ndërinstytucional/ndërministror përmes Komisionit të sapokrijuar	0
Zgjidhja e formulës më të përshtatshme të financimit të AFP-së dhe përshejtoni zbatimin e saj në të gjitha shkollat e AFP-së.	0
Hartimi në bashkëpunim me të gjitha ministritë përkatëse, agjencitë e tyre dhe palët e interesuara, dhe në përputhje me rekomandimet e BE/ILQ, një Plan Zbatues të Garancisë Rinore dhe filloni zbatimin e tij	0
Plotësimi dhe miratimi i Strategjisë për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Punë, me fokus të veçantë në përmirësimin e zbatimit të legjislacionit ekzistues dhe plotësimin e kuadrit ligjor për shëndetin në punë dhe sigurimin nga aksidentet dhe sëmundjet profesionale.	0
Sigurimi i miratimit të shpejtë të projektligjit për financat e pushtetit lokal	0
Publikimi i rregullt i raporteve të zbatimit të Strategjisë (2019-2023) dhe Planit të Veprimit (2019-2020) për Parandalimin e Ekonomisë Informale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimin Financiar	0
Zhvillimi dhe përdorimi i matjen përmes treguesve kryesorë të performancës në gjashtë pilot zona/sectorë të identifikuar, si bazë për matjen e performancës në Doganën e Kosovës	0
Miratimi i Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe ligjet për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (K4 2022), Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave dhe Tatimin mbi të Ardhurat Personale (K4 2022), në përputhje me praktikatat më të mira evropiane	0
Ministria e Financave të bëjë publike çmimet e shitjes së patundshmërive, të marra nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, si pjesë e kërkesës së tyre për të publikuar atributet që ndikojnë në vlerat e vlerësuara të pronës së paluajtshme. Fillimi i procesit drejt regjistrimit dhe publikimit të çmimeve të shitjes në nivel të Agjencisë Kadastrale të Kosovës	0
Zbutja e ndikimit të goditjeve të pafavorshme me masa mbështetëse të synuara mirë kur është e nevojshme, ndërsa planifikon kthimin në kufirin e deficitit prej 2% të PBB-së në afat të mesëm	0
Përgatitja e një rishikimi të sistemit të sigurimeve shoqërore, duke përfshirë pensionet e veteranëve të luftës, me synimin për të përmirësuar efikasitetin e kostos dhe drejtësinë e skemave të sigurimeve shoqërore, dhe një rishikim të shpenzimeve tatimore, duke përcaktuar sasinë e të ardhurave të harruara nga të gjitha përjashtimet dhe të reduktuara normat	0
Zbatimi i masave aktive të tregut të punës për të mbështetur punësimin, të rifillojë publikimin e të dhënave të anketës së fuqisë punëtore dhe të vazhdojë zbatimin e masave që synojnë formalizimin e punësimit informal	0
Ndjekja e reformave të thella në fushën e skemave të asistencës sociale për të siguruar një objektiv dhe ndikim më të mirë mbi varfërinë dhe për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve sociale në komuna	0
Përqindja	31%
Rezultati i përgjithshëm	4

Kriteri 3: Shkalla e zbatimit

Qëllimi i këtij vlerësimi është të matë zbatimin e masave të planifikuara në Programin Kombëtar për Integrim Evropian dhe Planin e Veprimit të Agjendës së Reformës Evropiane.

Masa	Afati	Referenca	Zbatimi
Numri i trajnimeve të mbajtura për Departamentin e Makros në MFPT dhe Njësinë për Monitorimin e NPve në ME përmes projektit rajonal të asistencë teknike të FMN-FAD të financuar nga BE	K4 2023	PKIE	1
Raportimi i rregullt gjashtëmuor i zbatimit të Planit të Veprimit të SMFP 2022-2024	K3 2023	PKIE	1
Raportimi i rregullt vjetor i zbatimit të Planit të Veprimit të SMFP 2022- 2024	K2 2023	PKIE	1
Hartimi i analizës së rreziqeve fiskale, përfshirë rreziqet që vijnë nga NP-të, e përfshirë në kornizën makro-fiskale, në dokumentet strategjike si KASH, ligji i buxhetit dhe PRE	K4 2023	PKIE	1
Raporte tremujore financiare dhe të performancës për të gjitha NP-të, të përgatitura	K4 2023	PKIE	1
Plani për Zbatimin e Skemës së Garantuar për të Rinj, i pilotuar	K4 2023	PKIE	1
Numri i grave të përfshira në masat aktive të tregut të punës, i rritur	K4 2023	PKIE	1
Numri inspektorëve të punës i rritur për 100 inspektorë shtesë	K4 2023	PKIE ERA (K4 2022)	1
Numri i inspektimeve nga Inspektorati i Punës, i rritur	K4 2023	PKIE	1
Skema e grantit për zanate	K4 2022	ERA	0
Projektligji për skemën e ndihmave sociale, i miratuar	K2 2022	ERA	0
Projektligji për sigurinë dhe shëndetin në punë, i hartuar dhe miratuar	K2 2021	ERA	0
Projektligji i punës, i miratuar	K2 2022	ERA	0
Sistemi i Teknologjisë së Informacionit të Inspektoratit të Punës, i themeluar	K4 2022	ERA	0
Programi shtetëror për inkurajimin e investimeve në eficiencën e energjisë duke subvencionuar familjet dhe bizneset që investojnë në këtë fushë, i miratuar	K4 2022	ERA	0
Projektligji për shërbimet e pagesave, i miratuar	K4 2023	PKIE	0
Koncept dokumenti për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, i miratuar	K1 2023	PKIE	1
Udhëzuesit për faktorët e rrezikut, të hartuar dhe miratuar	K4 2023	PKIE	1
Memorandum mirëkuptimi për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë mes NJIF dhe BQK, i nënshkruar	K4 2023	PKIE	1
Të paktën dy (2) aktiviteteve mbikëqyrëse të mentorimit, të zhvilluara	K4 2023	PKIE	1
Numri i ngritur i raporteve të pranuar të transaksioneve / aktiviteteve të dyshimta	K4 2023	PKIE	1
Metodologjitë për vlerësim të rrezikut, të rishikuara/hartuara	K3 2023	PKIE	1
Projekt -kodi për plotësim - ndryshimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë, i miratuar	K2 2023	PKIE	1
Luftimi i ekonomisë joformale dhe mashtrimin doganor përmes rritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet Doganës, agjencive të zbatimit të ligjit dhe institucioneve të tjera relevante, e matur përmes numrit të inspektimeve të realizuara, numri i operacioneve të ndërmarra, rezultatet e arritura	K4 2023	PKIE	1
Zhvendosja në pronë publike dhe funksionalizimi i plotë për së paku një (1) terminali doganor	K4 2023	PKIE	1
Koncept dokumenti për rishikimin e politikave tatimore, i miratuar	K2 2023	PKIE	0
Numri i aktiviteteve në kuadër të projekteve për përmirësimin e përmbushjes tatimore, i rritur	K4 2023	PKIE	1

Numri i kontrolleve dhe vizitave përmbushëse të bazuara në rrezik, i rritur	K4 2023	PKIE	1
Numri i veprimeve të ndërmarra për të përmirësuar pajtueshmërinë tatimore	K2 2023	ERA	1
Projektligji për plotësim - ndryshimin e Ligjit për Prokurimin Publik, i miratuar	K1 2023	PKIE ERA (K1 2022)	0
Projektligji për plotësimndryshimin e Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës, i miratuar	K2 2023	PKIE	0
Komitetet e auditimit të brendshëm në të gjitha organizatat buxhetore, përfshirë edhe nivelin komunal, të themeluara	K2 2023	PKIE	1
Koncept Dokumenti për themelimin e një trupi fiskal të pavarur i miratuar pas konsultimit me palët e interesit përfshirë edhe BE-në	K4 2021	ERA	0
Pesedhjetë (50) sesione informuese për komunitet, ministritë e linjës, institucionet rregullative dhe atyre të drejtësisë	K2 2023	ERA	1
Numri i skemave të harmonizuara me Rregullat e Ndhmës Shtetërore	K1 2023	ERA	0
Projektligji për ndihmë shtetërore, i rishikuar	K4 2022	ERA	0
Rregullorja për Ndhmën Horizontale, e miratuar	K4 2022	ERA	0
Numri i skemave shtesë të njoftuara në DNSH	K4 2023	PKIE	1
Përqindja			63%

Rezultati i përgjithshëm

7

Kriteri 4: Vlerësimi i raportit të vendit i BE-së

Çdo vit Komisioni Evropian publikon raportin vjetor të vendit për Kosovën. Në raport, KE përdor metodologji të matshme që lejon matjen e progresit vjetor të vendit në miratimin e detyrimeve të anëtarësimit në BE sipas përshkrimit të mëposhtëm: (0) kthim prapa; (1) nuk ka përparim; (2) progres i kufizuar; (3) disa përparime; (4) progres i mirë; (5) progres shumë i mirë. Qëllimi i këtij vlerësimi është të faktorizojë progresin që ka bërë çdo ministri e linjës gjatë periudhës së vlerësimit.

Kapitulli i raportit të vendit i BE-së

Vlerësimi i raportit të vendit i BE-së

Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale	0
Kapitulli 16: Tatimet	0
Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare	0
Kapitulli 19: Politika sociale dhe punësimi	0
Kapitulli 29: Bashkimi Doganor	0
Rezultati i përgjithshëm	0

Ministria për Kthim dhe Komunitete (MKK)



46/100 pikë

Ministria për Kthim dhe Komunitete (MKK) i përket grupit të ministrive me performancë të kufizuar. Ajo ka fituar gjithsej 46 pikë. Ndonëse masat e MKK-së në procesin integruar karakterizohen me kompleksitet të kufizuar, MKK ka siguruar një shkallë të lartë të zbatimit të kornizës planifikuese në fushën e integritimit evropian. Nga ana tjetër, MKK duhet të siguroj një harmonizim më të mirë në mes kornizës planifikuese dhe obligimeve në kuadër të agjendës evropiane.

Vlerësimi për kriterin 1:

Kompleksiteti i masave të planifikuara

Sa i përket kriterit një, respektivisht kompleksiteti i masave, MKK karakterizohet me masa të kompleksitetit të ultë. 25% të masave të MKK-së janë cilësuar si masa komplekse. Në përgjithësi, masat e MKK-së janë specifike dhe të matshme. Ndonëse ato përbëjnë detyrat rëndomta të ministrisë, ato bien nën fushën prioritare të procesit integruar, respektivisht të drejtave themelore.

Vlerësimi për kriterin 2:

Planifikimi i masave vs obligimet evropiane

Sa i përket kriterit dy, respektivisht harmonizimi në mes planifikimit të masave me obligimet në kuadër të agjendës evropiane, MKK karakterizohet me një shkallë të kufizuar të harmonizimit të planifikimit. 33% e obligimeve në kuadër të agjendës evropiane janë të adresuara në planifikimin e MKK-së. Në ciklet e ardhshme të planifikimit, MKK duhet të sigurohet se planifikimi adreson

kërkesën për ngritjen e Komisionit Ankues dhe funksionalizimin e bazës së të dhënave për monitorimin e strategjisë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Vlerësimi për kriterin 3:

Zbatimi i masave të planifikuara

Sa i përket kriterit tre, respektivisht nivelit të zbatimit të masave të planifikuara, MKK karakterizohet me një shkallë të konsoliduar të zbatimit. 75% e masave të parapara për vitin 2023 janë zbatuar. Duke shikuar në të ardhmen MKK duhet të siguroj ngritjen e Grupit Ndërmintor Koordinues për Zgjidhje të Qëndrueshme të Personave të Zhvendosur.

Vlerësimi për kriterin 4:

Vlerësimi i Komisionit Evropian

Sa i përket kriterit katër, respektivisht vlerësimin të Raportit vjetor për Kosovën nga ana e Komisionit Evropian, MKK ka marr vlerësim neutral prej 0 pikë. Kjo pasi që kapitulli për të cilin është pjesërisht përgjegjëse MKK, respektivisht kapitulli 23 – Drejtësia dhe të drejtat themelore nuk ka pësuar ndryshim në vlerësim në krahasim me vitin paraprak.

Kriteri 1: Kompleksiteti i masave

Ministritë planifikojnë masa të ndryshme në kuadër të Programit Kombëtar për Integrim Evropian dhe Agjendës së Reformës Evropiane. Në disa raste, këto masa janë relevante, të planifikuara mirë, strategjike, komplekse dhe të kujdesshme financiarisht. Në raste të tjera, ata nuk janë. Qëllimi i këtij vlerësimi është të bëjë dallimin ndërmjet masave të BE-së të planifikuara mirë dhe më pak të planifikuara mirë, duke shpërblyer kështu ministritë me performancë më të mirë.

Masat	Afati	Ref.	Specifike	E matshme	Reformë	Intensiteti i burimeve	Kompleksiteti ndërinstitucional	Nivelet e miratimit	Prioriteti i MSA-së dhe ERA-s	Masa përfaqëson Acquis	Ndeshmëria politike	Totali
Strategjia për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, e miratuar	K1 2023	PKIE	1	1	1	1	1	1	1	0	0	7
Deri në 56 të zhvendosur dhe të cenueshëm social në Komunën e Graçanicës, të sistemuar në njësi banimi të përhershëm	K4 2023	PKIE	1	1	0	1	0	0	1	0	0	4
Pesë (5) takime në nivelin komunal, sipas rajoneve, për zbatimin e Strategjisë për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre, të mbajtur	K4 2023	PKIE	1	1	0	0	0	0	1	0	0	3
Grupi koordinues ndërministror për zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur, i themeluar	K4 2021	ERA	1	1	0	0	0	0	1	0	0	3
Përqindja												25%
Rezultati i përgjithshëm												3

